



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNABANKAR EPUBLIKËK OSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# Buletini i Bilancit të Pagesave

S H T A T O R 2 0 1 0 / N R . 1 0



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# **Buletini i Bilancit të Pagesave**

**BOTUES** Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ©  
Zyra e Kryeekonomistit  
33 Garibaldi, Prishtinë 10 000  
Tel: ++381 38 222 243  
Fax: ++381 38 243 763

**Faqja e internetit** [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)

**Adresa elektronike** [statistics@bqk-kos.org](mailto:statistics@bqk-kos.org); [economicanalysis@bqk-kos.org](mailto:economicanalysis@bqk-kos.org)

**KRYEREDAKTOR** Gani GËRGURI

**REDAKTOR** Mentor GECI

## SHKURTESAT:

ATP	Agjensioni për Transferimin e Parasë
BE	Bashkimi Evropian
BEC	Kategoritë Kryesore Ekonomike
BP	Bilanci i Pagesave
BPM5	Manuali i Bilancit të Pagesave (edicioni i pestë)
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CEFTA	Marrëveshja Mbi Tregtinë e Lirë në Evropën Qendrore
EJL	Evropa Juglindore
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
KFOR	Forca Ushtarake e NATO-së në Kosovë
NNEK	Norma Nominale Efektive e Këmbimit
NREK	Norma reale Efektive e Këmbimit
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
pp	Pikë Përqindje
SRTN	Sistemi i Raportimit të Transaksioneve Ndërkombëtare
TKPK	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

## SIMBOLET KONVENCIONALE:

- " " dukuria nuk ekziston
- " . " dukuria ekziston, të dhënat nuk janë në dispozicion
- " ... " zero ose afër zeros
- (e) e vlerësuar
- (p) preliminare
- (r) e reviduar

## INFORMATË:

Për një përshkrim më të detajizuar të terminologjisë, ju lutem që t'i referoheni Metodikës mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave.





**PËRMBAJTJA:**

1. Përmbledhje Ekzekutive -----	7
2. Zhvillimet Ekonomike në Eurozonë dhe Evropën Juglindore-----	8
3. Zhvillimet Makroekonomike në Kosovë -----	9
4. Bilanci i Pagesave-----	13
4.1. Llogaria rrjedhëse -----	13
4.1.1 Mallrat dhe shërbimet -----	13
4.1.2 Të ardhurat dhe transferet rrjedhëse-----	18
4.2 Llogaria kapitale dhe financiare-----	19
4.2.1 Investimet e Huaja Direkte-----	19
4.2.2 Portfolio investimet, investimet tjera dhe asetet rezervë -----	22
5. Shtojca statistikore -----	23



**Lista e tabelave:**

Tabela 1. Llogaria rrjedhëse në vendet e EJL-së -----	9
Tabela 2. Bilanci tregtar i Kosovës, në milionë euro-----	14
Tabela 3. Indeksi i Performancës së IHD-ve -----	20

**Lista e figurave:**

Figura 1. Rritja reale e PBB-së-----	10
Figura 2. Indeksi i çmimeve të konsumit-----	11
Figura 3. Bilanci i llogarisë rrjedhëse -----	13
Figura 4. Kategoritë kryesore të strukturës së eksporteve -----	14
Figura 5. Kategoritë kryesore të strukturës së importeve-----	15
Figura 6. Importet sipas BEC-it -----	15
Figura 7. Struktura e eksporteve sipas partnerëve tregtarë-----	16
Figura 8. Struktura e importeve sipas partnerëve tregtarë -----	16
Figura 9. Llogaria e shërbimeve -----	17
Figura 10. Transferet rrjedhëse -----	18
Figura 11. Llogaria financiare neto-----	19
Figura 12. Struktura e IHD-ve sipas aktivitetit ekonomik -----	21
Figura 13. Investimet e huaja sipas vendit të origjinës-----	21

**Lista e kutive:**

Kutia 1. Indeksi i performancës së IHD-ve -----	20
---	----

## 1. Permbledhje Ekzekutive

Vitet 2008 dhe 2009 për ekonominë globale paraqitën vite me sfida të mëdha duke pasqyruar krizën ekonomike globale. Reflektimi i krizës financiare në ekonominë reale ishte mjaft i shpejtë gjë që ndikoi edhe që niveli global i tregtisë të pësojë rënie të theksuar. Si rezultat i rënies së aktivitetit tregtarë, rritja negative ekonomike ishte karakteristikë e shumë ekonomive botërore. Në vitin 2010, u shfaqën shenjat e para të stabilizimit ekonomik për shumë vende dhe përfundim të theksuar të aktivitetit tregtarë. Si rezultat i këtyre zhvillimeve, edhe ekonomitë e vendeve më të zhvilluar u përmirësua dhe rrjedhimisht, ndikoi që edhe aktiviteti ekonomik në vendet në zhvillim të përmirësohej. Edhe në rajonin e Evropës Juglindore (EJL) u shfaqën përmirësime të aktivitetit ekonomik dhe rritje pozitive e PBB-së. Eksportet nga vendet e EJL-së shënuan rritje si rezultat i rritjes së kërkesës në nivel global, përderisa, efekti i çmimeve ishte më i moderuar. Investimet e Huaja Direkte (IHD) në vitin 2010 konsiderohet se kanë vazhduar të shënojnë rënie në vendet e EJL-së, ndërsa, edhe asetet rezervë vazhdojnë të karakterizohen me një luhatshmëri të konsiderueshme.

Si rezultat i përmirësimeve, sidomos në kërkesën e jashtme, në ekonominë e Kosovës janë vërejtur disa përmirësime, veçmas në eksporte të cilat arritën nivelin më të lartë historik. Përkundër rritjes substanciale të eksporteve, niveli i lartë i importeve vazhdon të krijojë një deficit të theksuar tregtarë, dhe rrjedhimisht, deficit në llogarinë rrjedhëse. Deficiti i llogarisë rrjedhëse deri në fund të tremujorit të tretë arriti në 16.9 të PBB-së, që nëkrahim me vitin paraprak, paraqet një rritje të lehtë. Ndikim relativisht i lartë në thellimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse kishte rritja e theksuar e importit të shërbimeve krahas nivelit relativisht të ngashëm në eksport të kësaj kategorie. Bilanci i të ardhurave ishte relativisht i ngashëm me vitin paraprak, duke rezultuar në efekt të vogël në llogarinë rrjedhëse. Dërgesat e emigrantëve, përkundër rënies modeste, vazhdojnë të jenë një komponentë e cila në masë të konsiderueshme ngushton deficitin e llogarisë rrjedhëse. Gjatë kësaj periudhe, dërgesat e emigrantëve shënuan rënie të modeste. Në kuadër të transfereve rrjedhëse, ndikim pozitiv në llogarinë rrjedhëse kishin edhe transferet e realizuara për qeverinë qendrore.

Llogaria kapitale dhe financiare u karakterizuar rënie të lehtë të bilancit pozitiv. Investimet e huaja direkte vazhduan të kenë një nivel relativisht të ngjashëm me vitin paraprak, ndërsa, rënia e lehtë e bilancit pozitiv të llogarisë kapitale dhe financiare më shumë i adresohet rritjes së theksuar të portfolio investimeve si dhe rritjes së aseteve rezervë. Kategoria e 'investimeve tjera' gjatë kësaj periudhe u karakterizuar me rënie gjë që ndikoi në përmirësimin e llogarisë kapitale dhe financiare.

## 2. Zhvillimet ekonomike në Eurozonë dhe Evropën Juglindore

Gjatë gjysmës e parë të vitit 2010 vendet e eurozonës u karakterizuan me zgjerim të vazhdueshëm të aktivitetit ekonomik, përdërisa në tremujorin e tretë 2010, PBB-ja e eurozonës shënoi një rritje kuartale prej 0.4 përqind. Rritja ekonomike në eurozonë kryesisht i atribuohet riaktivizimit të kërkesës vendore si dhe rigjallërimit të vazhdueshëm të ekonomisë globale, e cila rezultoi në rritjen e kërkesës për eksportet e eurozonës. Përmirësimi i gjendjes ekonomike në vendet e eurozonës në masë të madhe i atribuohet edhe masave të ndërmarra nga autoritetet e këtyre vendeve që kishin për qëllim restaurimin e sektorit financiar si dhe nxitjen e aktivitetit të përgjithshëm ekonomik. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2010 Banka Qendrore Evropiane (BQE) vazhdoi të mbajë normën bazë të interesit në nivel të ulët prej 1 përqind. Ndër masat e ndërmarra vlen të veçohet themelimi i Fondit Evropian për Stabilitet Financiar në vlerë prej 440 miliardë euro. Ky fond është themeluar me qëllim të ruajtjes së stabilitetit financiar, si dhe për t'iu siguruar ndihmë 27 vendeve anëtare të Bashkimit Evropian (BE), në rast të vështirësive buxhetore. Po ashtu, Komisioni Evropian miratoi programin për ndihmë drejtuar bankave me probleme të prekura nga kriza kreditore në Greqi. Ndërsa, sa i përket tejkalimit të krizës buxhetore në Greqi, FMN dhe vendet tjera të eurozonës ndihmuan Greqinë me 110 miliardë euro.

Deri në tremujorin e tretë 2010, shkalla e papunësisë në eurozonë ishte mesatarisht 10 përqind. Në kuadër të vendeve të eurozonës, Spanja dhe Irlanda regjistruan shkallën më të lartë të papunësisë, prej 20 përkatësisht 14 përqind. Norma vjetore e inflacionit në eurozonë deri në gusht 2010 arriti në 1.6 përqind (-0.2 përqind në gusht 2009).

Gjatë vitit 2010, zhvillime pozitive u shënuan edhe në ekonomitë e vendeve të Evropës Juglindore (EJL). Në tremujorin e tretë 2010, të gjitha vendet e EJL-së shënuan rritje ekonomike, megjithëse me normë të moderuar të rritjes. Shqipëria është një ndër vendet e rajonit që prinë me normën më të lartë të rritjes ekonomike prej 4.9 përqind, pasuar nga Serbia dhe Mali i Zi me rritje prej 2.7 përkatësisht 2.0 përqind. Vendet e rajonit, megjithatë, vazhdojnë të kenë norma të larta të papunësisë. Vendet që raportuan normën më të lartë të papunësisë në vitin 2010 ishin Kosova (rreth 45 përqind; vlerësim i vitit 2009), Bosnja e Hercegovina (43.2 përqind) dhe Maqedonia (31.7 përqind). Sa i përket inflacionit, norma më e lartë u shënuan në Serbi (7.7 përqind) dhe Kosovë (4.4 përqind).

Nga tremujori i dytë në tremujorin e tretë 2010, në eurozonë u regjistrua rritje e eksporteve, megjithëse me ritëm të ngadalshëm. Rritja e eksporteve në tremujorin e tretë 2010 ishte rezultat i rritjes së vëllimit, ndërkohë që çmimet e eksporteve u rritën në masë të moderuar. Po ashtu, në krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2009, eksportet e eurozonës në tremujorin e tretë 2010 shënuan rritje prej 24.6 përqind. Në anën tjetër, edhe importet e eurozonës shënuan rritje vjetore 28 përqind, duke kontribuar kështu në përkeqësimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse në eurozonë. Deficiti i llogarisë rrjedhëse në tremujorin e tretë 2010 u rrit në 16.4 miliardë euro (0.4 miliardë në tremujorin e tretë 2009). Llogaria e shërbimeve në eurozonë shënoi bilanc pozitiv, ndërsa llogaria e të ardhurave shënoi deficit. Deficiti i llogarisë së të ardhurave në eurozonë erdhi si pasojë e rënies së të ardhurave nga investimet dhe zvogëlimit të portfolio investimeve. Sa i përket llogarisë financiare, në tremujorin e tretë 2010, eurozona shënoi rënie si të investimeve të huaja direkte (IHD) ashtu edhe të portfolio investimeve.

Viti 2010 u karakterizua me përmirësim të indikatorëve ekonomik edhe në vendet e EJJ-së. Gjatë këtij viti, bilanci tregtar dhe bilanci i llogarisë rrjedhëse në vendet e EJJ-së në përgjithësi u përmirësua. Megjithatë, deficitet e llogarisë rrjedhëse akoma mbetet i lartë në disa prej vendeve të rajonit, si në Mal të Zi (32.1 përqind e PBB-së), Kosovë (16.9 përqind e PBB-së) dhe Shqipëri (11 përqind e PBB-së). Mirëpo, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, deficitet e llogarisë rrjedhëse në Mal të Zi dhe Shqipëri ka shënuar rënie, kryesisht për shkak të përmirësimit të bilancit tregtar. Ndryshe nga viti 2009, viti 2010 u karakterizua me rritje të konsiderueshme të eksporteve dhe me rritje më të ngadalësuar të importeve në të gjitha vendet e EJJ-së. Në vendet e rajonit, në tremujorin e tretë 2010 rritja më e madhe e eksporteve u shënuar në Kosovë dhe Shqipëri me 92.4 përkatësisht, 51 përqind. Megjithatë, në rastin e Kosovës dhe Shqipërisë, duhet marrë parasysh bazën e vogël të eksporteve. Ndërsa, sa i përket importeve, Maqedonia regjistroi normën më të lartë të rritjes prej 20.4 përqind, pasuar nga Serbia me rritje vjetore prej 17.3 përqind.

**Tabela 1. Llogaria rrjedhëse në vendet e EJJ-së (kumulative deri në shtator 2010)**

Përshkrimi	Bilanci i llogarisë rrjedhëse (% e PBB-së)	Eksportet (ndryshimi vjetor, në %)	Importet (ndryshimi vjetor, në %)
Shqipëria	-11.2	50.9	13.4
Bosnja dhe Hercegovina	-6.4	23.1	16.8
Kosova	-16.9	92.4	12.3
Kroacia	-2.9	17.0	4.9
Mali i Zi	-32.3	17.2	6.6
Maqedonia	-1.9	18.5	20.4
Serbia	-8.3	24.6	17.3

Burimi: Komisioni Evropian dhe bankat qendrore të vendeve përkatëse

Deri në shtator 2010, të gjitha vendet e EJJ-së u karakterizuan me rënie të IHD-ve. Ndër vendet e rajonit, Bosnja dhe Hercegovina shënoi rënien më të lartë të IHD-ve (137 përqind), pasuar nga Serbia dhe Maqedonia, ku IHD-të u zvogëluan për 41 përkatësisht 20 përqind. Ndërsa, normë më të ulët të rënies së IHD-ve deri në shtator 2010 regjistruan Shqipëria e Kosova (me nga rreth 2 përqind) dhe Kroacia (0.3 përqind). Asetet rezervë deri në shtator 2010 në Bosnje e Hercegovinë dhe Kosovë shënuan ngritje, ndërsa në Serbi dhe Shqipëri shënuan rënie në masë të konsiderueshme. Në Kroaci, niveli i aseteve rezervë mbeti i ngjashëm me atë të një viti më parë.

### 3. Zhvillimet Makroekonomike në Kosovë

Ekonomia e Kosovës vazhdon të karakterizohet me nivel të kënaqshëm të stabilitetit makroekonomik përkundër zhvillimeve globale sidomos në periudhën 2008-2009. Rritja reale e PBB-së vazhdoi të jetë pozitive edhe gjatë vitit 2009, ndërsa parashikimet sugjerojnë normë edhe më të lartë të rritjes për vitin 2010. Burime të rëndësishme të financimit të konsumit dhe investimeve vazhdojnë të jenë kreditë e lëshuara nga bankat komerciale që operojnë në Kosovë si dhe dërgesat e emigrantëve. Sidoqoftë, prodhimi vendor vazhdon të jetë në nivel të ulët, duke bërë që ekonomia e Kosovës në masë të madhe të mbështetet në importimin e mallrave nga jashtë. Adaptimi i valutës euro si valutë


zyrtare në Kosovë ka minimizuar rrezikun nga norma e këmbimit dhe ka lehtësuar zhvillimin e tregtisë me vendet tjera. Sfida kryesore për ekonominë e Kosovës vazhdon të jetë norma e lartë e papunësisë, sidomos duke pasur parasysh nivelin e ulët të gjenerimit të vendeve të reja të punës në krahasim me rritjen e fuqisë punëtore.

Ekonomia e Kosovës gjatë periudhës 2008-2009 u ndikua nga kriza globale më së shumti nëpërmjet sektorit të jashtëm. Ndikimi i krizës kryesisht u reflektua nga dërgesat e emigrantëve si dhe investimet e huaja direkte të cilat në vitin 2009 shënuan rënie prej 5.5 përkatësisht 23.3 përqind. Lëvizjet e mëdha të çmimeve të metaleve bazë në tregjet globale ndikuan që eksportet e Kosovës të ndikohen në masë të madhe, marrë parasysh se eksportet e Kosovës në masë të konsiderueshme përbëhen nga metalet bazë. Si rezultat i këtyre zhvillimeve, sektori bankar në Kosovë shtoi kujdesin në financimin e ekonomisë duke shtrënguar kredidhënien në këtë periudhë. Në anën tjetër, ndryshimi i politikave fiskale gjatë vitit 2009 ka kontribuar në zvogëlimin e efekteve negative nga kriza globale. Kjo pasi që shpenzimet publike shënuan rritje të konsiderueshme dhe si rezultat i kësaj rritjeje u neutralizua efekti i krizës. Përveç rritjes së shpenzimeve, ulja e normës së tatimit për korporatat mund të ketë stimuluar investimet të cilat në vitin 2009 janë rritur më shumë se 6 përqind. Zvogëlimi i normës së tatimit në të ardhurat personale mund të ketë pasur ndikim pozitiv në nivelin e konsumit në vend, mirëpo, rritja e TVSH-se mund të ketë mënjanuar deri në një masë efektin e zvogëlimit të normës tatimore në të ardhurat personale duke bërë presion në nivelin e përgjithshëm të çmimeve.

Bazuar në të dhënat e Entit të Statistikës së Kosovës (ESK), konsumi gjatë vitit 2009 shënoi rënie në terma nominal, mirëpo, për shkak të deflacionit, në terma real konsumi shënoi rritje krahasuar me vitin paraprak. Në terma real, edhe investimet shënuan normë pozitive të rritjes gjatë vitit 2009. Prandaj, ekonomia e Kosovës në vitin 2009 shënoi një normë reale të rritjes prej 2.9 përqind, bazuar në vlerësimet e ESK-së, ndërsa, vlerësimet e FMN-së tregojnë për normë reale të rritjes ekonomike prej 3.8 përqind (Figura 5).

Fillimi i rikuperimit të ekonomive të vendeve të zhvilluara nga kriza ka filluar të reflektohet edhe në ekonominë e Kosovës. Për vitin 2010, parashikimet tregojnë për rritje të konsumit dhe investimeve në vend të cilat pritet që të jenë bartësit kryesor të rritjes ekonomike. Në këtë kontekst, deri në tremujorin e tretë të vitit 2010 është vërejtur rënie e lehtë e dërgesave të emigrantëve dhe nivel relativisht i ngjashëm i investimeve të huaja direkte krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, përderisa eksportet janë dyfishuar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Gjithashtu, rritja e shpenzimeve publike paraqet një kontribues të rëndësishëm për ngritjen e konsumit dhe investimeve në vend. Përmirësimet në sektorin e jashtëm kanë ndikuar që edhe bankat komerciale të përmirësojnë perceptimin e tyre për ambientin ekonomik në Kosovë, gjë që ka ndikuar në stabilitet në kredidhënie. Deri në shtator 2010, kreditë shënuan rritje për 10.9 përqind. Rritja e kredive në masë të madhe i atribuohet kreditimit të ekonomive familjare

Figura 1. Rritja reale e PBB-së



Burimi: FMN (2010), dhe ESK (2010a)

ndaj të cilave kreditë u rritën për 27.3 përqind, ndërsa, kreditë për ndërmarrjet shënuan një rritje modeste për rreth 5.2 përqind. Në këtë rritje të kredive ndaj ndërmarrjeve, vlen të theksohet se rritja më e shpejtë e kredive është vërejtur në sektorin e ndërtimitarisë dhe në sektorin e prodhimitarisë, ndërsa kreditë për sektorin e tregtisë kanë shënuar rritje prej 4.8 përqind. Si rezultat i këtyre zhvillimeve, norma reale e rritjes së PBB-së gjatë vitit 2010 është parashikuar të arrijë në 4.6 përqind sipas projeksioneve të FMN-së, ndërsa MEF parashikon rritje reale prej 4.8 përqind (IMF, 2010; MEF, 2010).


Çmimet gjatë pjesës së parë të vitit 2010 mund të konsiderohet si stabile, mirëpo, në muajt e fundit është vërejtur rritje më e theksuar krahasuar me pjesën tjetër të vitit 2010 (Figura 2). Rritja vjetore e indeksit të çmimeve të konsumit deri në shtator 2010 ishte 5.9 përqind, ndërsa mesatarja vjetore ka arritur në 1.6 përqind. Ndikimin më të madh në nivelin e përgjithshëm të çmimeve deri në tremujorin e tretë të vitit 2010 e kishin çmimet e produkteve ushqimore dhe të

shërbimeve të transportit personal, të ndikuara nga çmimet e karburanteve në tregjet ndërkombëtare. Çmimet e importit vazhdojnë të kenë ndikim të madh në nivelin e përgjithshëm si rezultat i ekonomisë së bazuar në imperte, ndërsa si rezultat i mungesës së instrumenteve të politikës monetare, instrumentet e autoriteteve vendore për të ndikuar në nivelin e çmimeve janë tejet të kufizuara. Prandaj, ecuria e çmimeve në ekonominë e Kosovës kryesisht diktohet nga lëvizjet e çmimeve në sektorin e jashtëm. Çmimet e importit deri në shtator 2010, krahasuar me shtatorin 2009, shënuan ngritje të theksuar prej 7.8 përqind gjë që reflekton ndikimin e madh të çmimeve nga tregjet ndërkombëtare në çmimet në Kosovë. Në anën tjetër, çmimet e prodhimit mund të konsiderohen me një nivel më të lartë të stabilitetit pasi që rritja e tyre në shtator 2010 krahasuar me shtator 2009 ishte 2.2 përqind dhe njëkohësisht, ndikimi i tyre në nivelin e përgjithshëm të çmimeve mbetet më i limituar.

Papunësia vazhdon të paraqesë sfidën më të madhe në ekonominë e Kosovës. Anketa e Fuqisë Punëtore në Kosovë e realizuar nga ESK, vlerëson se në vitin 2009 norma e papunësisë në Kosovë ishte rreth 45 përqind e fuqisë punëtore. Mirëpo, ekonomia e Kosovës dallon nga shumë vende tjera të rajonit dhe të BE-së pasi që kriza globale në vendet tjera ndikoi në rritjen e normës së papunësisë, ndërsa në Kosovë norma edhe ashtu e lartë e papunësisë nuk paraqitet të jetë ndikuar nga kriza globale, përkundrazi, papunësia në Kosovë gjatë vitit 2009 shënoi rënie për 2pp.

Politika fiskale në Kosovë në periudhën e pasluftës ka qenë mjaft konservative, qasje kjo e cila ndikoi që buxheti i Kosovës të karakterizohet me teprica buxhetore ose me nivele të ulëta të deficitit. Kjo pasi që politika fiskale deri diku ka reflektuar mundësitë e kufizuara të qeverisë për të financuar deficitet buxhetore (p.sh. mungesa e ligjit për borxh publik deri në vitin 2009). Rrjedhimisht, burimet e vetme për financimin e deficitit buxhetor ishin rezervat e grumbulluara nga periudhat me tepriçë buxhetore si dhe donacionet direkte buxhetore nga komuniteti ndërkombëtar.

Figura 2. Indeksi i Çmimeve të Konsumit, ndryshimi vjetor



Burimi: ESK (2010)

Shpenzimet publike në Kosovë kishin rol mjaft të rëndësishëm në zbutjen e efekteve nga kriza ekonomike, mirëpo, për dallim nga vendet e tjera ku shpenzimet ishin të orientuara në dhënie të ndihmës për institucionet financiare, në Kosovë politika fiskale ishte e koncentruar në rritjen e shpenzimeve gjë që shkaktoi rritje të nivelit të përgjithshëm të konsumit dhe investimeve me theks të veçantë në investimet publike.

Karakteristikë e Buxhetit të Kosovës për vitin 2009 ishte deficiti prej 2.2 përqind të PBB-së që rezultoi nga rritja më e shpejtë e shpenzimeve në krahasim me rritjen e të hyrave. Norma e rritjes së shpenzimeve buxhetore për vitin 2009 ishte 29.7 përqind, ndërsa të hyrat buxhetore përkundër ndikimit nga efektet e krizës u rritën për 21.7 përqind. Burimi kryesor i të hyrave buxhetore vazhdojnë të hyrat e mbledhura në kufi (55.3 përqind e gjithsej të hyrave) si rezultat i nivelit të lartë të importeve. Varësia e lartë e buxhetit në të hyrat nga një burim bënë që buxheti i vendit të ketë ndjeshmëri të lartë ndaj tronditjeve në tregtinë me jashtë. Në këtë kontekst, në vitin 2009 është vërejtur ngadalësim i rritjes së të hyrave të mbledhura në kufi si pasojë e zvogëlimit të importit gjatë kësaj periudhe, ndërsa kontribut pozitiv në rritjen e këtyre të hyrave ka pasur rritja e normës së TVSH-së nga 15 në 16 përqind që nga fillimi i vitit 2009. Sidoqoftë, ndikimin kryesor në rritjen e të hyrave buxhetore e kishte transferimi i dividendës së PTK-së.

Deri në tremujorin e tretë 2010, të hyrat buxhetore shënuan një trend më të shpejtë të rritjes krahasuar me shpenzimet, duke rezultuar në një suficit buxhetor prej 113.5 milionë euro. Përderisa të hyrat shënuan një rritje vjetore prej 33.4 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, shpenzimet buxhetore u rritën për 7.8 përqind. Sipas buxhetit të rishikuar, viti 2010 pritet të mbyllet me një deficit buxhetor prej 3.7% të PBB-së.

Aprovimi i ligjit për huamarrjen publike si dhe anëtarësimi i Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore paraqesin zhvillime me rëndësi për financat publike në vend dhe për zhvillimet ekonomike në përgjithësi. Në qershor 2010, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) për herë të parë miratoi aranzhmanin 'stand-by' për Kosovën në vlerë prej 108.9 milionë euro (SDR 92.9 milionë) që përbën 157 përqind të gjithsej kuotës së Kosovës në FMN. Ky aranzhman është aprovuar për një periudhë kohore prej 18 muajsh. Fillimisht Kosova mund të tërheqë 22.1 milionë euro, ndërsa tërheqja e kësteve tjera do të bëhet sipas rishikimeve tremujore. Njëkohësisht, aprovimi i programit financiar me FMN-në ka hapur mundësinë e shfrytëzimit të donacioneve buxhetore të zotuar nga Komisioni Evropian dhe Banka Botërore. Megjithatë, gjatë tremujorit të dytë, Kuvendi i Kosovës nuk ratifikoi kredinë e aprovuar nga Banka Botërore, në vlerë prej 20 milionë dollarë, që kishte për qëllim modernizimin e administratës publike.


## 4. Bilanci i Pagesave<sup>1</sup>

Deri në shtator të vitit 2010, pozicioni i jashtëm i Kosovës u karakterizua me thellim të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Rritja e deficitit ishte kryesisht pasojë e bilancit negativ të tregtisë së mallrave dhe zvogëlimit të bilancit pozitiv në llogarinë e shërbimeve. Përkundër normës më të lartë të rritjes së eksporteve në krahasim me importet, deficitit tregtar në shtator 2010 ishte për 13.2 përqind më i lartë krahasuar me shtator 2009. Kjo reflekton peshën e lartë që kanë importet në strukturën e përgjithshme të tregtisë së Kosovës me vendet tjera. Bilanci pozitiv në llogarinë e të ardhurave dhe transfereve rrjedhëse vazhdoi të kontribuojë në zvogëlimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse në ekonominë e Kosovës. Llogaria e të ardhurave si dhe ajo transfereve rrjedhëse janë karakterizuar me një rritje vjetore prej 7.4 përkatësisht 13.6 përqind deri në shtator 2010. Rritja e theksuar e investimeve në letra me vlerë, por edhe rënia e lehtë e IHD në ekonominë e Kosovës ndikuan që llogaria kapitale dhe financiare të karakterizohen me rënie vjetore prej 14.6 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2009.

### 4.1 Llogaria rrjedhëse

Deri në shtator të vitit 2010, deficitin në llogarinë rrjedhëse arriti vlerën prej 512.2 milion euro, një rritje vjetore prej 13.7 përqind. Raporti ndërmjet deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe PBB-së në shtator 2010 arriti në 16.9 përqind, krahasuar me 15.5 përqind në periudhën e njëjtë në vitin 2009. Bilanci negativ në llogarinë e tregtisë së mallrave vazhdon të jetë kontribuuesi kryesor në rritjen e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Rënia e shënuar në bilancin e tregtisë së shërbimeve (90.1 përqind) ndikoi po ashtu në përkeqësimin e bilancit të llogarisë rrjedhëse. Bilanci pozitiv i transfereve rrjedhëse vazhdon të ndikojë në zbutjen e deficitit të llogarisë rrjedhëse (Figura 3).

Figura 3. Bilanci i llogarisë rrjedhëse, në milion euro



Burimi: BQK 2010

#### 4.1.1 Mallrat dhe shërbimet

Rritja e vazhdueshme e shkëmbimeve tregtare ndërmjet Kosovës dhe vendeve tjera ka bërë që shkalla e hapjes tregtare (e matur si shuma e importeve dhe eksporteve perpjësuar me PBB-në) në Kosovë të arrijë në 57.3 përqind e PBB-së në shtator 2010 (51.5 përqind në shtator 2009). Shkalla e lartë e importeve dhe niveli mjaft i ulët i eksporteve ka bërë që Kosova vazhdimisht të ketë një normë mjaft të ulët të mbulueshmërisë së eksporteve me importe. Megjithatë, rritja më e theksuar e eksporteve krahasuar me importet në vitin 2010 ka rezultuar në shkallë më të lartë të mbulueshmërisë së eksporteve me importe, gjegjësisht në 13.8 përqind në shtator 2010 (8.1 përqind në periudhën e njëjtë të vitit

<sup>1</sup> Statistikat e Bilancit të Pagesave të Kosovës në këtë publikim janë kumulative për periudhën janar-shtator 2010.



paraprak). Bilanci tregtar i Kosovës deri në shtator 2010 shënoi një deficit prej 1.34 miliard euro apo rreth 43.4 përqind e PBB-së (43.8 përqind e PBB-së në 2009).

Tabela 2. Bilanci tregtar i Kosovës, në milionë euro

Përshkrimi	2007	2008	2009	2010
Eksportet	120.6	159.6	111.4	214.3
Importet	1,128.6	1,375.8	1,383.3	1,553.1
Bilanci tregtar	(1,007.9)	(1,216.3)	(1,271.8)	(1,338.8)
Raporti eksport/import (%)	10.7	11.6	8.1	13.8
Hapja tregtare	48.8	53.2	51.5	57.3

Burimi: BQK 2010


Deri në shtator të vitit 2010, importet arritën vlerën 1.6 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 12.3 përqind (Tabela 2). Rritja vjetore e importeve në këtë periudhë ishte kryesisht rezultat i rritjes së çmimeve, pasi që në terma real, importet u rritën me 7.3 përqind. Në periudhën e njëjtë, eksportet arritën vlerën prej 214.3 milion euro (111.4 milion euro deri në shtator 2009), një rritje vjetore prej 92.4 përqind. Në terma real, deri në shtator 2010, eksportet shënuan një rritje vjetore prej 88.2 përqind, duke reflektuar kështu stabilizimin e kërkesës dhe çmimeve në nivel ndërkombëtar. Çmimet relativisht më të larta në Kosovë krahasuar me vendet e BE-së dhe vendet e CEFTA-s ndikuan që norma reale efektive e këmbimit (angl. Real Effective Exchange Rate: REER) të vlerësohet (revalvim). Të dhënat deri në shtator 2010 tregojnë se REER është vlerësuar ndaj vendeve të eurozonës për 0.6 përqind si dhe ndaj vendeve të CEFTA-s për 1.5 përqind.

Kategoria me ndikimin kryesor në rritjen e përgjithshme të eksporteve të Kosovës, deri në shtator 2010, ishin metalet bazë të cilat, njëherësh, paraqesin kategorinë më të madhe në kuadër të mallrave të eksportuara nga Kosova.

Duke arritur shumën prej 134.8 milion euro (56.9 milion euro në shtator 2009), metalet bazë kontribuuan në rritjen e gjithsej eksporteve me rreth 69.9 pp (Figura 4). Si rrjedhojë, eksportet e metaleve bazë rriten pjesëmarrjen e tyre në gjithsej eksportet nga 51.1 përqind në shtator 2009, në 62.9 përqind në shtator 2010. Rritja e kërkesës së jashtme gjatë vitit 2010 dhe si dhe rritja e çmimeve për metalet bazë kanë nxitur rritjen e aktivitetit në industrinë e metaleve në Kosovë gjatë kësaj periudhe.

Kategoria e dytë për nga kontributi në rritjen e përgjithshme të eksporteve në vend ishin produktet minerale, me rreth 7.6 pp. Pjesëmarrja e tyre u zvogëluar nga 16.5 përqind e gjithsej eksporteve sa ishte në vitin 2009 në 12.5 përqind në shtator të vitit 2010. Eksporti i këtyre produkteve shënoi rritje vjetore prej 46.1 përqind në periudhën raportuese. Një kategori tjetër që rriti pjesëmarrjen në gjithsej eksportet ishte kategoria e makinerive dhe pajisjeve që në shtator 2010 përfaqësoi 4.3 përqind të gjithsej eksporteve (3.3 përqind në shtator 2009) dhe kontribuoi me 4.9 pp në rritjen e përgjithshme

Figura 4. Kategoritë kryesore të strukturës së eksporteve, në përqindje



Burimi: BQK 2010


të eksporteve (Figura 4). Kjo kategori kryesisht dominohet nga eksporti i energjisë elektrike.

Struktura e importeve në ekonominë e Kosovës vazhdon të jetë e ngjashme me vitin paraprak (Figura 5). Përderisa në vitin 2009 produktet minerale pësuan rënie, në vitin 2010 kjo kategori e importeve kishte rritje prej 30.3 përqind. Kjo gjithashtu rezultoi edhe në rritje të pjesëmarrjes së produkteve minerale në gjithsej importet (19.6 përqind deri në shtator 2010 krahasuar me 16.9 përqind në shtator 2009). Kontributi i produkteve minerale në rritjen e importeve ishte 5.1pp.

Në vitin 2010, importi i makinerive dhe pajisjeve shënoi rritje vjetore prej 6.5 përqind dhe përfaqësoi kategorinë e dytë më të madhe me 13.4 përqind të gjithsej importeve. Metalet bazë përbëjnë po ashtu një kategori të rëndësishme në strukturën e importeve, të përfaqësuara me 8.9 përqind në shtator 2010. Po ashtu, importi i produkteve ushqimore shënoi një rritje vjetore prej 10.3 përqind, duke rritur kështu pjesëmarrjen në gjithsej importet në 13.0 përqind (11.7 përqind në vitin 2009).


Sa i përket klasifikimit të produkteve të importuara sipas qëllimit të përdorimit të tyre apo sipas Kategorive Kryesore Ekonomike (angl. Broad Economic Categories: BEC), deri në shtator 2010, struktura ishte relativisht e njëjtë me vitin paraprak. Përderisa produktet e ndërmjetme dhe mallrat e konsumit vazhduan të kontribuojnë pozitivisht në rritjen e importeve (11.4 përkatësisht 3.7pp) në periudhën janar - shtator të vitit 2010, mallrat kapitale kontribuuan negativisht në rritjen e importeve me rreth 1.6 pp. Kategoria më e rëndësishme sipas këtij klasifikimi përfaqësohet nga produktet e ndërmjetme, që kanë një pjesëmarrje prej rreth 46.8 përqind në gjithsej importet (Figura 6). Sipas këtij klasifikimi, kategoria e dytë më e rëndësishme përbëhet nga mallrat e konsumit, që kanë një pjesëmarrje prej 30.9 përqind në gjithsej importet. Përderisa në vitet paraprake, pjesëmarrja e mallrave kapitale kishte shënuar rritje të vazhdueshme, në vitin 2010 mallrat kapitale shënuan rënie në pjesëmarrjen e tyre nga 12.8 përqind (në vitin 2009) në 10.0 përqind në shtator 2010. Pjesëmarrja e ulët e importit të mallrave kapitale në vend tregon për një ritëm të ngadalshëm të investimeve në vend dhe, si rrjedhojë, edhe nivel të ulët të prodhimit vendor, gjë që shpjegohet edhe nga pjesëmarrja e lartë e mallrave të konsumit në gjithsej importet. Për

Figura 5. Kategoritë kryesore të strukturës së importeve, në përqindje



Burimi: BQK 2010

Figura 6. Importet sipas BEC-it



Burimi: BQK 2010

më tepër, pjesëmarrja e lartë e importit të mallrave të ndërmjetme tregon se deri diku aktiviteti prodhues në vend mbështet në masë të madhe në importin e lëndës së parë nga jashtë.


Deri në shtator 2010, struktura e partnerëve tregtarë të Kosovës, për sa i përket tregtisë së mallrave, ishte e ngjashme me periudhat e kaluara. Partnerët kryesorë tregtarë mbeten vendet e Bashkimit Evropian (BE) dhe vendet anëtare të CEFTA-s, vende këto me të cilat Kosova realizoi 72.8 përqind të tregtisë në periudhën deri në shtator 2010. Rikuperimi i tregjeve në vendet e BE-së u reflektua pozitivisht në eksportet e Kosovës drejt këtyre vendeve, që shënuan

rritje më të lartë vjetore krahasuar me eksportet drejt vendeve të CEFTA-s. Rritja më e theksuar e eksporteve drejt vendeve të BE-së në krahasim me vendet e CEFTA-s u ndikua edhe nga pengesat për eksportimin e mallrave nga Kosova drejtë Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës pasi që këto dy vende, për shkaqe politike, vazhdojnë të mos e implementojnë marrëveshjen e CEFTA-s në raport me Kosovën. Për më tepër, përderisa problemet në zbatimin e marrëveshjes së CEFTA-së ishin aktuale edhe gjatë vitit 2010, nga fundi i vitit 2010 Kosova nuk do të përfitojë nga statusi i vendeve të favorizuara për tregti me BE-në, gjë që do të paraqesë një sfidë shtesë për prodhuesit Kosovarë që të depërtojnë në tregjet evropiane. Deri në shtator 2010, eksportet e Kosovës në BE arritën vlerën prej 95.2 milion euro, krahasuar me 46.1 milion euro në periudhën e njëjtë në vitin paraprak. Pjesëmarrja e eksporteve të Kosovës në drejtim të vendeve të BE-së arriti në 44.4 përqind të gjithsej eksporteve dhe shënoi rritje vjetore prej 3.0 pp (Figura 7).

Sa i përket destinacionit të eksporteve të Kosovës, në kuadër të vendeve të BE-së, Italia paraqet destinimin kryesor. Duke përfaqësuar 28.2 përqind të gjithsej eksporteve të Kosovës, eksportet drejt Italisë kapën vlerën prej 60.5 milion euro deri në shtator 2010 (29.7 milion euro në periudhën e njëjtë një vit më parë). Rreth 70.0 përqind e eksporteve në Itali janë eksporte të xeheve të nikelit. Eksportet drejt Gjermanisë, Austrisë dhe Sllovenisë po ashtu kanë rritur pjesëmarrjen e tyre në gjithsej eksportet deri në shtator 2010.


Shpërndarja gjeografike e eksporteve drejt vendeve të CEFTA-s mbeti e ngjashme me periudhat paraprake. Megjithëse vlera e eksporteve drejt vendeve të CEFTA-s shënoi rritje vjetore prej 40.3 përqind, pjesëmarrja e tyre në gjithsej eksportet e Kosovës u zvogëluar në 24.9 përqind në shtator 2010 nga 34.2 përqind në shtator 2009. Në kuadër të vendeve të CEFTA-s, Kosova vazhdon të

Figura 7. Struktura e eksporteve sipas partnerëve tregtarë, në përqindje



Burimi: BQK 2010

Figura 8. Struktura e importeve sipas partnerëve tregtarë, në përqindje




Burimi: BQK 2010

eksportoje më së shumti në Shqipëri dhe Maqedoni, ku eksportohen 11.7 përkatësisht 8.9 përqind të gjithëj eksporteve të Kosovës. Megjithatë, krahasuar me shtator 2009, pjesëmarrja e eksporteve në këto dy vende u zvogëlua për rreth 6.2 përkatësisht 3.0 pp. Për dallim nga periudhat paraprake, vlera e eksporteve drejt Bosnjës e Hercegovinës dhe Serbisë ka shënuar rritje përkundër pengesave të vëna nga këto vende për eksportet e Kosovës. Përderisa deri në shtator 2009, vlera e mallrave të eksportuara nga Kosova në Bosnje e Hercegovinë kishte vlerën prej vetëm 0.6 milion euro, deri në shtator 2010 eksportet drejt këtij vendi arritën vlerën prej 1.8 milion euro. Ngjashëm shënuan rritje edhe eksportet e Kosovës drejtë Serbisë, të cilat në shtator 2010 arritën vlerën prej 2.8 milion euro krahasuar me 1.1 milionë euro deri në shtator 2009.

Deri në shtator 2010, pjesëmarrja e mallrave të importuara nga vendet anëtare të BE-së në gjithëj importet e Kosovës ishte 38.5 përqind (38.8 përqind në vitin 2009) (Figura 8). Gjermania përbën vendin nga i cili Kosova importon pjesën më të madhe të mallrave (13.0 përqind të gjithëj importeve). Vendi i dytë me pjesëmarrjen më të madhe në importet nga vendet e BE-së deri në shtator 2010 ishte Greqia, nga ku janë importuar 5.1 përqind e gjithëj importeve të Kosovës. Sa i përket vendeve të CEFTA-s, Kosova vazhdon të importojë pjesën më të madhe të mallrave nga Maqedonia (15.0 përqind të gjithëj importeve) dhe Serbia (11.9 përqind të gjithëj importeve).

Llogaria e tregtisë së shërbimeve në periudhën deri në shtator 2010 kishte bilanc pozitiv, por, për dallim nga vitet e mëparshme, bilanci i kësaj llogarie shënoi një rënie të theksuar krahasuar me periudhën paraprake. Në shtator 2010, bilanci i shërbimeve shënoi vlerën prej 10.1 milion euro, përderisa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kjo llogari kishte një bilanc prej 101.1 milion euro (Figura 9). Zvogëlimi i bilancit të llogarisë së shërbimeve reflekton rritjen më të ngadalshme të të

Figura 9. Llogaria e shërbimeve, në milion euro



Burimi: BQK 2010

hyrave nga shitja e shërbimeve për jo-rezidentët, krahasuar me rritjen e pagesave për shërbimet e blera jashtë vendit nga rezidentët Kosovarë. Më konkretisht, bilanci pozitiv i shërbimeve u zvogëlua në periudhën janar – shtator 2010 krahasuar me zvogëlim kryesisht si pasojë e rritjes së pagesave për shërbimet e ndërtimit, të orientuara për ndërtimin e segmentit të parë të autostradës Morinë-Merdarë ndikoi në zvogëlimin e bilancit pozitiv të shërbimeve në periudhën janar – shtator 2010. Të hyrat nga shërbimet e udhëtimit (që dominohen kryesisht nga udhëtimet personale) kontribuan me rreth 7.1 pp në rritjen e gjithëj të hyrave nga shërbimet. Të hyrat nga shërbimet e udhëtimit shënuan rritje vjetore prej 16.3 përqind deri në shtator 2010, përderisa pagesat për shërbimet e udhëtimit shënuan rritje vjetore prej 69.2 përqind. Rritja më e shpejtë e pagesave për shërbime ka ndikuar që deri në shtator 2010, bilanci i shërbimeve të udhëtimit të jetë 74.9 milionë euro krahasuar me 89.6 milionë euro sa ishte deri në shtator 2009. Në këtë kategori hyjnë kryesisht udhëtimet personale të rezidentëve kosovarë (kryesisht udhëtimet për pushime vjetore). Në të njëjtën kohë, të hyrat nga shërbimet e komunikimit shënuan rritje vjetore prej rreth 2.5 përqind ndërkaq pagesat për këto shërbime shënuan rritje prej


